KOMBET E BASHKUARA

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr.: IT-04-84-PT

Data: 21 mars 2007

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: **Gjykatësit Alphons Orie, Kryegjykatës**
Gjykatësit Frank Höpfel
Gjykatësit Ole Bjørn Støle

Sekretari: **Z. Hans Holthuis**

Vendim i datës: **21 mars 2007**

PROKURORJA

kundër

Ramush HARADINAJT
Idriz BALAJT
Lahi BRAHIMAJT

VENDIM MBI MOCIONIN KONFIDENCIAL TË PROKURORISË PËR DËSHMI QË DO TË DËGJOHET PËRMES VIDEOKONFERENCËS

Zyrës së Prokurores:

Z. David Re
Z. Gramsci de Fazio
Z. Gilles Dutertre
Z. Philip Kearney

Avokatëve të Ramush Haradinajt:

Z. Ben Emmerson, QC
Z. Rodney Dixon

Avokatit të Idriz Balajt:

Z. Gregory Guy-Smith
Zj. Colleen Rohan

Avokatëve të Lahi Brahimajt:

Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop

1. Më 2 mars 2007 Prokuroria dorëzoi një mocion konfidencial për të dëgjuar dëshminë e një dëshmitari me videokonferencë.[1] Më 6 mars 2007 Dhoma kërkoi informacion shtesë nga Prokuroria,[2] e cila dorëzoi shtojcën përkatëse konfidenciale të mocionit[3] pas së cilës Mbrojtja e dha përgjigjen në gjykatë.[4] Më 7 mars 2007, Dhoma e hodhi poshtë gojarisht mocionin në bazë të arsyeve të mëposhtme.[5] Arsyet për vendimin jepen më poshtë.

2. Në Rregullën 71 *bis* të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit parashtrohet se, "Me kërkesë të cilësdo pale dhe duke vepruar në interes të drejtësisë, Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë që dëshmia të bëhet përmes videokonferencës".

3. Kriteret në mbështetje të interesave të drejtësisë pasqyrohen në jurisprudencën e Tribunalit: (a) dëshmitari nuk duhet të jetë në gjendje ose duhet të ketë arsye bindëse për mosgatishmëri për ardhjen në Tribunal, (b) dëshmia e dëshmitarit duhet të jetë e rëndësishme në atë masë saqë mungesa e saj të shkaktojë padrejtësi për palën kërkuese që të vazhdojë më tej (c) i akuzuari nuk duhet të paragjykohet në të drejtën e tij ose të saj për t'u ballafaquar me dëshmitarin.[6]

4. Interesat e drejtësisë kërkojnë që si rregull dëshmia duhet të jepet në gjykatë. Për lehtësi dëshmitarët mund të parapëlqejnë të dëshmojnë nëpërmjet videokonferencës në vend që të vijnë në Hagë. Mirëpo thjesht shprehja e këtij parapëlqimi nuk është arsye bindëse për mosardhjen në Tribunal.

5. Prokuroria argumentoi se dëshmitari nuk është i gatshëm të vijë në Hagë sepse ai nuk ndihet i qetë në lidhje me këtë dhe është i shqetësuar për sigurinë e tij dhe të familjes së tij.[7]

6. Mbrojtja argumentoi veçanërisht se shqetësimet e shprehura për sigurinë nuk ishin provuar në mënyrë të mjaftueshme.[8]

---

[1] Prosecution's Motion for Testimony to Be Heard via Video-Conference Link, 2 March 2007/Mocion i Prokurorisë për Dëshminë që Do Të Dëgjohet përmes Videokonferencës, 2 mars 2007.
[2] T. 460
[3] Prosecution's Addendum to Motion for Testimony to Be Heard via Video-Conference Link, 6 March 2007/Shtojca e Prokurorisë për Mocionin për Dëshmi që Do Të Dëgjohet përmes Videokonferencës, 6 mars 2007
[4] T. 554
[5] T. 613.
[6] *Delalić et.al.*, Decision on the Motion to Alloë Witnesses K, L and M to Give Their Testimony by means of Video-link Conference, Trial Chamber, 28 May 1997, para.17./*Delaliq dhe të tjerët.*, Vendim mbi Mocionin për Lejimin e Dëshmitarëve K, L, dhe M që të Japin Dëshminë e tyre përmes Videokonferencës, 28 maj 1997, paragrafi 17.
[7] Poshtëshënimi i mësipërm 1, në paragrafin 7. Më tej Prokuroria theksoi se dëshmitari nuk kishte pasaportë apo dokumentet e nevojshme për lëshimin e saj. Mirëpo ajo pranoi se autoritetet vendore kishin premtuar ta pajisnin dëshmitarin me pasaportë. në kohë.

7. Dhoma gjykon se Prokuroria nuk ka provuar se dëshmitari nuk ka mundësi të vijë në Hagë. Gjithashtu Prokuroria nuk ka treguar arsye bindëse për mosgatishmërinë e dëshmitarit për udhëtimin në Hagë. Shqetësimet për sigurinë të shprehura prej dëshmitarit të pambështetura prej hollësive apo argumenteve, nuk përbëjnë arsye bindëse, duke qenë se ato mund të zgjidhen nëpërmjet një kërkese për masa mbrojtëse dhe nuk është treguar se ato do të kishin zgjidhje nëpërmjet dhënies së dëshmisë me videokonferencë krahasuar me dhënien e dëshmisë gojore në Hagë. Rrjedhimisht Prokuroria nuk ka provuar se do të ishte në interes të drejtësisë që dëshmia e dëshmitarit të dëgjohej nëpërmjet videokonferencës.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Alphons Orie
Kryegjykatës

Sot, më datën 21 mars 2007.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]

[8] T.555.